

Letërnjoftimi i Komunës së

VUSHTRISË

2014

Maj, 2015



Fakte


- Të hyrat buxhetore të Komunës së Vushtrrisë më 2014 kanë shënuar rritje prej 500 mijë euro në krahasim me një vit më parë.
- Në administratë komunale janë të punësuar 216 persona, apo një shërbyes civil për 329 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Komuna e Vushtrrisë ka edhe së paku 6 të punësuar me kontratë mbi vepër. Këta të punësuar me kontratë mbi vepër janë të angazhuar për periudha mbi një vjeçare.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 1,104 persona, prej tyre 863 mësimdhënës. Në Komunën e Vushtrrisë raporti nxënës/mësimdhënës është 38.4. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 220 persona. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Vushtrrisë është 323.7. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Komuna e Vushtrrisë gjatë vitit 2014 ka pasur 6,588 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Vushtrri rreth 9.2% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 178 biznese të reja. Për dallim nga viti paraprak tani shohim një zvogëlim të numrit të bizneseve, që do të thotë se kemi një rënie prej 92 biznese më pak sesa në vitin 2013.
- Gjatë vitit 2014, janë shuar 54 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.
- Kryetari i Vushtrrisë Bajram Mulaku gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 10 premtime nga fusha të ndryshme. Deri në maj 2015, shkalla e realizueshmërisë së premtimeve është 20%, apo nën mesatare në shkallë vendi, e cila është 24%.

2 Qeverisja komunale

Komuna e Vushtrrisë në zgjedhjet e fundit lokale (2013) ka zgjedhur qeverisjen e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Kryetari aktual i Vushtrrisë z.Bajram Mulaku (PDK) ka fituar mandatin pas balotazhit, i zhvilluar mes tij dhe ish Kryetarit nga radhët e AAK- LDD z.Muharrem Shabani.


Në raundin e parë në zgjedhje kanë votuar 31,306 apo rreth 47,02% qytetarë me të drejtë vote. Në balotazhin e mbajtur me 1 dhjetor 2013, Bajram Mulaku ka marr 55,2%, ndërsa Muharrem Shabani ka rezultuar me 44%.

Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave në raundin e parë dhe në balotazh



Zgjedhjet për Kuvend Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: PDK 12 ulëse, LDK 7 ulëse, AAK-LDD 6 ulëse, VV 3 ulëse, PD dhe AKR me nga 2 ulëse, dhe me nga një ulëse G.I SERPSKA, LB dhe KDTP.

Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë në bazë të zgjedhjeve 2013




Ekzekutivi komunal i Vushtrrisë ka 12 drejtori.

3 Buxheti i Komunës së Vushtrrisë

Më 2014, Komuna e Vushtrrisë kishte buxhet prej 14 milion eurove, me një rritje prej afro 2 milion euro në krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe mëditje për 1,166 të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë. Buxheti për investime kapitale është 3.9 milion euro, një rritje e lehtë në krahasim me dy vitet paraprake.


Grafikoni nr. 3 Buxheti total i Komunës së Vushtrrisë dhe kategoritë kryesore buxhetore



Instituti GAP

Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Vushtrrisë janë 1.7 milion euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje në krahasim me vitin 2013.


Grafikoni nr.4 Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Vushtrrisë 2011-2015



Instituti GAP


Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë afro 30% të të hyrave të përgjithshme.

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore



Në krahasim me komunat tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Vushtrrisë ka arritur të mbledh më shumë të hyra nga tatimi në pronë se sa komuna si Skenderaj, Malisheva, Shtime, Vitia, Istog, etj.


Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë



4 Të punësuarit në sektorin publik


Vitin 2014 Komuna e Vushtrrisë e ka përmbyllur me 1.540 të punësuar në sektorin publik, 14 më pak sesa një vit më parë.

Grafikoni nr.9 Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Vushtrrisë



Komuna e Vushtrrisë ka të punësuar një shërbyes civil për 329 banorë. Në krahasim me komunitat tjera, Komuna e Vushtrrisë ka më pak të punësuar në administratën lokale, në krahasim me popullsinë që ka. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori




Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Komuna e Vushtrrisë ka edhe së paku 6 të punësuar me kontratë mbi vepër. Këta të punësuar me kontratë mbi vepër janë të angazhuar për periudhë mbi një vjeçare.

Grafikoni nr.11 Të punësuar me kontratë mbi vepër




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 1,104 persona, prej tyre 863 mësimdhënës. Në Komunën e Vushtrrisë raporti nxënës/mësimdhënës është 38.4. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9. Edhe në sektorin e arsimit, ashtu sikurse në shërbimin civil, Komuna e Vushtrrisë ka të punësuar më pak staf se sa mesatarja në shkallë vendi.

Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Vushtrrisë



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 220 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Vushtrrisë është 323.7. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.


Grafikoni nr.13 Punonjës shëndetësor për kokë banori



5 Ekonomia lokale

Në Komunën e Vushtrrisë gjatë vitit 2014 janë regjistruar 178 biznese të reja, një numër më i vogël se sa që ishin regjistruar në dy vitet paraprake. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara më 2014 janë biznese me fushë veprimtari tregtare.


Grafikoni nr.14 Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Instituti GAP

Por, në të njëjtën periudhë, janë shuar 54 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.

Grafikoni nr.15 Llojet e bizneseve të shuara më 2014




Në përgjithësi, Komuna e Vushtrrisë radhitet ndër komunit me probleme të mëdha ekonomike, për shkak të papunësisë së lartë dhe ambientit jo të favorshëm të të bërit biznes.

6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Bajram Mulaku gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 10 premtimet e monitoruara, del se deri në maj 2015 z. Mulaku ka arritur të realizoj 20% te premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunit e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

Grafikoni nr.16 Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





Instituti GAP

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2
+381 38 609 339

info@institutigap.org
www.institutigap.org
www.komunat.institutigap.org

